



# ▶ STOP MURTAJËN AFRIKANE TË DERRAVE

**Murtaja afrikane e derrave (MAD)** është një sëmundje virale që prek derrat e butë dhe derrat e egër. Ky virus është i padëmshëm për njerëzit, por shkakton probleme të konsiderueshme socio-ekonomike në vendet e prekura.

▶▶ Njerëzit mund ta përhapin lehtësisht dhe pa vetëdije sëmundjen kur bien në kontakt me një kafshë të infektuar ose me materiale të infektuara.



**Gjuetarët si ju mund të ndihmojnë** në ndalimin e përhapjes së kësaj sëmundjeje vdekjeprurëse duke raportuar raste të dyshimta dhe duhet të mbani mend:



Asnjëherë mos iu afroni një derri të egër të ngordhur ose të sëmurë, qëndroni larg dhe raportoni tek autoritetet vendore sa më shpejt të jetë e mundur.



Dezinifektoni pajisjet tuaja përpara se të largoheni nga zona e gjuetisë.



Mos lini organet e brendshme dhe mbetjet e derrave të egër në pyje dhe fusha.



Mos ushqeni kafshët me mish gjahu.



Shmangni vizitat në fermat e derrave pas gjuetisë.

Aktualisht nuk ka një vaksinë të aprovuar për MAD në Evropë, ndaj **masat parandaluese janë e vetmja mënyrë për të ndaluar përhapjen e kësaj sëmundjeje vdekjeprurëse.**

**Bëni pjesën tuaj** për të mbrojtur derrat e egër, derrat e butë dhe njerëzit, jetesa e të cilëve varet prej tyre. **Së bashku, ne mund të ndalojmë përhapjen e MAD.**

**Për më shumë informacion rreth MAD vizitoni:** [www.efsa.europa.eu/StopASF](http://www.efsa.europa.eu/StopASF)

Për të raportuar rastet e dyshuara të derrave të infektuar telefononi në numrin 08003366.



EFSA është gur themeli i BE-së për hulumtimin e rrezikshmërisë në lidhje me sigurinë e ushqimit dhe procesin e ushqyerjes. Në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kombëtare dhe në konsultim të hapur me aktorët e saj, EFSA ofron këshilla të pavarura shkencore dhe komunikim të qartë lidhur me rreziqet ekzistuese dhe rreziqet që kanosen. ISBN 978-92-9499-575-9 | DOI: 10.2805/46444 | TM-03-22-022-SQ-N

**#StopASF**

Burim shkencor për sigurinë e ushqimit